

Eppc Kosovo kërkon një **Agjent të Shitjes dhe Marketingut** për klientin e saj, një ndër kompanitë lidere të ndërtimit dhe shitjes së patundshmërive në vendin tonë.

Përgjegjësitë kryesore:

- Merret me promocion dhe shitje të pronave;
- Bënë negociimin, ndërmjetësimin dhe konsultat me klientët për kushtet e tregut, çmimet, hipotekat, kërkesat ligjore dhe të gjitha çështjet tjera relevante, duke siguruar një trajtim të drejtë dhe të ndershëm;
- Bënë analiza krahasuese të tregut për të përcaktuar vlerën e pronave;
- Përcakton nevojat dhe mundësitë financiare të klientëve për t'iu propozuar zgjidhjet që u përshtaten atyre;
- Nxitë ngritjen e shitjeve përmes kanaleve të ndryshme të marketingut;
- Përgatitë dokumentet e nevojshme për operim;
- Mirëmban dhe rifreskon listat me detajet e nevojshme të pronave në dispozicion;
- Mirëmban dhe zhvillon rrjetin e bashkëpunimit me palët e interesuara.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare;
- Përvojë në shitje dhe marketing (preferohet njohja e arkitekturës) ;
- Aftësi të forta shitëse, negociuese dhe komunikuese;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe aftësi të shkëlqyera ndërpersonale;
- Njohuri të gjera rreth tregut të patundshmërive në Kosovë dhe jo vetëm;
- Njohja e shkëlqyeshme e pakos së MS Office;
- Njohja e mirë e Gjuhës Angleze.

Të dhënat:

Pozicioni:	Agjent i Shitjes dhe Marketingut;
Vendndodhja:	Prishtinë;
Paga:	Shumë konkurruese;
Kontrata:	Sipas Ligjit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	06.11.2019.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke përmendur në subject pozicionin **'Agjent i Shitjes dhe Marketingut'** në adresën e e-mail-it:

kosovo@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.